

| KOMUNA GLLOGOC<br>GLLOGOC MUNICIPALITY |         |              |       |
|----------------------------------------|---------|--------------|-------|
| Pranuar                                |         | 23. 12. 2020 |       |
| Nj. Org.                               | Numër   | Shtojca      | Vlera |
| 08                                     | 032/11- | SS           | 869   |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Komuna e Drenasit**



**Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit**

## **PLANI I PUNËS I DREJTORISË PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT PËR VITIN 2021**

**Dhjetor, 2020**

## **I. HYRJE**

**DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT, NË ASPEKTIN FUNKSIONAL ËSHTË E ORGANIZUAR NË DY SEKTORË:**

- 1. SEKTORI I PLANIFIKIMIT URBAN**
- 2. SEKTORI I MBROJTJES SË MJEDISIT**

Drejtoria në përgjithësi dhe sektoret e saj në veçanti janë të obliguara të ndërmarrin hapat dhe veprimet procedurale, konform përgjegjësiave për realizimin e objektivave të parapara me planprogramin e saj, me qëllim të inkorporimit të strategjisë dhe objektivave të ekzekutivit, gjithnjë duke u bazuar në obligimet që dalin nga Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statuti 01-Nr.110-6904 dt. 24.09.2008 i Komunës së Glllogocit.

## **PLANI I PUNËS I DREJTORISË PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT PËR VITIN 2021**

### **DEKLARATA E MISIONIT:**

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT ËSHTË BARTËSE E HARTIMIT TË: PLANIT ZHVILLIMOR TË KOMUNËS, HARTËS ZONALE TË KOMUNË DHE PLANEVE RREGULLATIVE URBANE TË HOLLËSISHME, BËNË IMPLEMENTIMIN E TYRE, CAKTON KUSHTET E NDËRTIMIT, LËSHON LEJET E NDËRTIMIT, KUJDESET PËR DOKUMENTACIONIN INVESTIVO- TEKNIK DHE PËRPUTHSHMËRINË E TIJ ME KUSHTET E DHËNA URBANO-TEKNIKE, LEJON SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE, MBULON SFERËN E BANIMIT, BASHKËPUNIMIN I NGUSHTË ME QEVERINË - MINISTRINË E EKONOMISË DHE AMBIENTIT.

## **I. SEKTORI PËR PLANIFIKIM URBAN**

Planifikimi dhe objektivat e përgjithshme të Sektorit për Planifikim Urban për vitin 2021

1.1 Miratimi dhe zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit për periudhën 2020-2028.

1.2 Përfundimi i hartimit dhe miratimit të Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit, për periudhën 2021-2029.

1.3 Shqyrtimi i kërkesave dhe lëshimi i kushteve të ndërtimit, lejeve të ndërtimit në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim.

1.4 Lëshimi i Certifikatës së Përdorimit të objekteve, sipas Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.05/2019 për Mbikëqyrje Inspektuese dhe Procedurën për Lëshimin e Certifikatës së Përdorimit.

1.5 Dhënia e pëlqimeve urbanistike për bashkim dhe parcelizim të parcelave kadastrale sipas Ligjit Nr.04/L-013 për Kadastër.

1.6 Hartimi i planeve rregulluese të hollësishme urbane.

1.7 Mirëmbajtja e sistemit të adresave, vendosja e tabelave dhe numrave në terren.

## **II. SEKTORI I MBROJTJES SË MJEDISIT**

Planifikimi dhe objektivat e përgjithshme të Sektorit për Mbrojtje të Mjedisit për vitin 2021

1.1 Zbatimi i Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal, 2020-2028.

1.2 Zbatimi i Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Glllogocit, 2021-2029.

1.3 Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, 2020-2028.

1.4 Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit, 2020-2028.

1.5 Përgatitja e raporteve për gjendjen e zonave të mbrojtura në Komunën e Glllogocit.

1.6 Inicimi i procedurave për shpallje zonë e mbrojtur sipas Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës.

1.7 Shënimi i Ditës Botërore të Biodiversitetit, 22 maj 2021.

1.8 Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit 5 qershor 2021, dhe përkrahja e iniciativave në ruajtjen e mjedisit.

1.9 Gjelbërimi i hapësirave publike në vitin 2021.

### III. PROCESI I LEGALIZIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe miratimin e pesë Udhëzimeve Administrative që dalin nga Ligji Nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje trajtohen të gjitha ndërtimet pa leje deri në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit (5 shtator 2018), dhe janë krijuar parakushtet e nevojshme për fillimin e procesit të legalizimit dhe me këtë rast krijohet mundësia e pranimit të aplikacioneve për ndërtimet pa leje.

Komuna e Drenasit ka filluar me procesin e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe deri me tani ka marr 26 Vendime për Dhënien e Certifikatës së Legalizimit, 13 Vendime për përfshirje në Listë të Pritjes, dhe pranohen aplikacione për legalizim të ndërtimeve pa leje të cilat janë në proces, duke u shqyrtuar nga zyrtarët e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Në vitin 2021, parashihet të vazhdohet me legalizim të ndërtimeve pa leje duke u trajtuar sipas Ligjit Nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, dhe duke vazhduar me iniciativa të vetëdijesimit, dhe përgatitje të broshurave, organizimin e takimeve me qytetare për t'i informuar për procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje.



Drejtori për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

Flutura Aydiu